

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“CLOUD KITCHEN” SH.P.K**

---

Me vullnetin tonë të lirë, të shprehur edhe me nënshkrimin e këtij Akt-Themelimi në cilësinë e ortakëve themelues, ne:

- **Z. FAHRETTIN AMIR ARMAN**, shtetas shqiptar, lindur në Ankara, Turqi, më 30/03/1956, mbajtës i kartës së identitetit të Republikës së Shqipërisë me nr. 033665304 dhe me nr. personal F60330209B, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- **Z. YIGIT ARMAN**, shtetas shqiptar lindur në Ankara, Turqi, më 07/02/1986, mbajtës i kartës së identitetit të Republikës së Shqipërisë me nr. 034301839 dhe me nr. personal I60207113A, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- **ZNJ. ALTINGUL ARMAN**, shtetase turke, lindur në Ankara, Turqi, më 26/03/1983, mbajtëse e pashaportës së Republikës së Turqisë me nr. U25111604, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- **Z. MUSTAFA CANBERK OZ**, shtetas turk, lindur në Altindag, Turqi, më 11/07/1995, mbajtës i pashaportës së Republikës së Turqisë me nr. U22998474, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

krijojmë sot më datë 10/01/2023 shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “CLOUD KITCHEN” SH.P.K me akt themelimi si vijon:

Akt Themelimi i shoqërisë tregtare “CLOUD KITCHEN” SH.P.K është i mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në fuqi të Republikës së Shqipërisë, të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe të Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

**Neni 1**

**Forma dhe emri i shoqërisë**

Krijohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar e quajtur “CLOUD KITCHEN” SH.P.K. Shoqëria do t’i nënshtrohet legjislacionit Shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen do t’i nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues.

**Neni 2**

**Selia e Shoqërisë**

Selia e shoqërisë “CLOUD KITCHEN” SH.P.K do të jetë në adresën:

- **Rruga “Selim Brahja”, afër shkollës “Ibrahim Brahja”, Sauk, Tiranë**

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë sipas parashikimeve të Statutit.

**Neni 3**

**Objekti i Veprimtarisë**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj tregtar në fushat ai vijojnë; Menaxhim, operim Bar, Kafe, Pub, Restorant, Hotel, duke përfshirë këtu të gjithë ambjentet argëtuese; Përgatitje, prodhim, shërbim, shpërndarje, catering, delivery të të gjitha llojeve të ushqimeve; Tregtim me shumicë dhe pakicë të të gjitha dhe çdo lloji të mallrave dhe produkteve ushqimorë, industriale, etj; Dhënie

## "CLOUD KITCHEN" SH.P.K

---

konsulence për sa më sipër; Import – eksport i çdo lënde të parë, malli, pajisje, makinerie, shërbimi dhe produkti në funksion të aktivitetit; Shërbime reklame dhe marketingu të mallrave, artikujve dhe produkteve të ndryshme; Blerje, shitje, operim, marrje me qira, dhënie me qira, transkasion të çdo lloji në lidhje me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme në funksion të aktivitetit. Tregtim, import – eksport të çdo lloji artikulli produkti, malli dhe shërbimi, tregtim online, etj.

Objekti i Shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve sipas kushteve për ndryshimin e Statutit.

### Neni 4

#### Kohëzgjatja e Shoqërisë

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat. Ajo mund shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfardo lloji shkaku.

### Neni 5

#### Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar fillestar i Shoqërisë është 100 lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e Shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre, si mëposhtë.

**Ortaku themelues FAHRETTIN AMIR ARMAN:**

- Numri i pjesëve : 1.00 (një)
- Kuota e pjesëmarrjes : 55.00 % (pesëdhjetë e pesë përqind), kontribut në para
- Vlera e Kontributit : 55.00 (pesëdhjetë e pesë) lekë

**Ortaku themelues YIGIT ARMAN:**

- Numri i pjesëve : 1.00 (një)
- Kuota e pjesëmarrjes : 25.00 % (njëzetëpesë përqind) kontribut në para
- Vlera e Kontributit : 25.00 (njëzetëpesë) lekë

**Ortaku themelues ALTINGUL ARMAN:**

- Numri i pjesëve : 1.00 (një)
- Kuota e pjesëmarrjes : 10.00 % (dhjetë përqind) kontribut në para
- Vlera e Kontributit : 10.00 (dhjetë) lekë

**Ortaku themelues MUSTAFA CANBERK OZ:**

- Numri i pjesëve : 1.00 (një)
- Kuota e pjesëmarrjes : 10.00 % (dhjetë përqind) kontribut në para
- Vlera e Kontributit : 10.00 (dhjetë) lekë

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

### Neni 6

#### Drejtimi i Shoqërisë

Shoqëria do të drejtohet nga Administratori i shoqërisë, i cili është:

➤ **YIGIT ARMAN**, me adresë Vilat Rolling Hills, Vila Nr. 79, Mullet, Tiranë

Administratori është përfaqësues i Shoqërisë në marrëdhënie me të tretët dhe kanë kompetenca të plota në drejtimin e saj. Çdo kontratë do të kryhet prej tyre dhe në rast mungese nga një përfaqësues i pajisur me prokurë të posaçme.

Specimenti i nënshkrimit:



A.A.

V





**“CLOUD KITCHEN” SH.P.K**

---

**Neni 7  
Të ardhurat**

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë Ortakëve të shoqërisë.

**Neni 8  
Emërimet**

Ortakët themelues kanë të drejtë të emërojnë dhe administratorë të tjerë, ka të drejtë të caktojnë financiarë, likuidator për problemet e shoqërisë si dhe të pajtojnë persona të tjerë si ortakë.

**Neni 9  
Zgjidhja e konflikteve**

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit Shqipëtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**Neni 10  
Vula e shoqërisë**

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme, me tekstin rreth saj.

**Neni 11  
Autorizimi për regjistrim**

Autorizohet Z. Altin Kodra, si Përfaqësues i autorizuar për kryerjen e të gjithë procedurave të nevojshme për regjistrimin e shoqërisë në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme dhe ligjore si dhe nënshkrimin e çdo dokumenti për rregjistrimin e kësaj shoqërie pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

*Akti i themelimit u përpilua në 4 (katë) kopje, për t'ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë “CLOUD KITCHEN” SH.P.K.*

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakët e shoqërisë

**“CLOUD KITCHEN” SH.P.K**

**FAHRETTIN AMIR ARMAN**



**ALTINGUL ARMAN**



**YIGIT ARMAN**



**MUSTAFA CANBERK OZ**

